

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5623
E enjte, 8 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Veseli: Mosliberalizimi i vizave është racizëm i skajshëm

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KUVENDI MIRATOI REZOLUTËN PËR SHITESA TË FËMIJËVE DHE PROJEKTLIGJIN PËR REFERENDUMIN F. 7

DEMOKRATËT FITOJNË DHOMËN E PËRFAQËSUESVE, REPUBLIKANËT E MBAJNË SENATIN F. 2

BËHET DORËZIMI I DEKORATAVE "HEROI I KOSOVËS" PËR FAMILJARËT E 158 HERONJVE F. 6

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESHI



Pozita po përdorë dy standarde për dialogun

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, i ka kritikuar subjektet e koalicionit qeverisës se po përdorin dy standarde në raport me dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto parti ndryshe po deklarohen në opinion rreth këtij procesi e ndryshe po veprojnë në Kuvendin e

Kosovës. Sipas Kurteshit, nëse pozita dëshiron të tregojë se është kundër idesë së presidentit Hashim Thaçi për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi duhet ta votojë projektrezolutën e opozitës. Ndërkaq dialogun e dy presidentëve në Bruksel, deputeti Kurteshi e ka quajtur ilegal



Thaçi e Vuçiqi takohen sot në Bruksel

Me ndërmjetësimin e shesës për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, sot (e enjte) në Bruksel do të takohen presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ish-ministria e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë se ky takim s'mund të jetë hyrje në fazën

finale sepse, sipas saj, Kosova mund të marrë pjesë në finale të dialogut kur Kuvendi e autorizon delegacionin shtetëror. Edhe Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se është problematik fakti që Thaçi merr pjesë në bisedime përdoris Kosova nuk ka një platformë shtetërore për dialogun me Serbinë

Shala: Masa mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja do të mbetet në fuqi



FAQE 9

EKONOMI

LLUKA: KOSOVA DHE GREQIA DO TA RRSIN BASHKËPUNIMIN EKONOMIK F. 8

KLUBI I PRODHUESVE, MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS F. 9

KULTURË

LETRAT E BURGUT SI TEKSTE LETRARE F. 12

Sadik KRASNIQI

SPORT

PRISHTINA MPOSHTI FERONIKELIN, MERR POZITËN E PARË F. 14

SADIKU DHE ISMAJLI I BASHKOHEN SHQIPËRISË F. 14

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Demokratët fitojnë Dhomën e Përfaqësuesve, republikanët e mbajnë Senatin

Në zgjedhjet e së martës për Kongresin, demokratët morën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve, ndërsa republikanët mbajtën kontrollin e Senatit, duke krijuar një Kongres të ndarë që do të vendosë pengesa ndaj programit legjislativ të presidentit Donald Trump në dy vjetët e ardhshëm



WASHINGTON, 7 NËNTOR - Demokratët morën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në zgjedhjet e së martës për Kongresin, ndërsa republikanët mbajtën kontrollin e Senatit, duke krijuar një Kongres të ndarë që do të vendosë pengesa ndaj programit legjislativ të presidentit Donald Trump në dy vjetët e ardhshëm.

Kryetarja e pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, në krah të figurave të tjera demokrate me peshë, doli para mbështetësve demokratë, duke thënë se është një ditë e re për Amerikën. "Urime të gjithë atyre kandidatëve të jashtëzakonshëm, dinamikë, të larmishëm që e riorientojnë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në emër të popullit amerikan. Dita e sotme nuk është thjesht për demokratët apo republikanët, është për rikthimin e kontroleve dhe balancave ndaj administratës së presidentit Trump", tha Pelosi.

Megjithatë demokratët fituan në disa gara kyçe të martën, ata nuk realizuan atë që po quhej "valë blu" fitoresh në zgjedhjet e Kongresit dhe që analistët kishin thënë se do të kishte qenë një kundërshtim ndaj presidencës së presidentit Donald Trump.

Mbajtja e kontrollit të Senatit nga republikanët u duk thajse e padiskutueshme kur demokratët humbën gara kyçe në Indiana dhe Tennesi, dy shtete që presidenti Trump i fitoi lehtë-

sisht në vitin 2016. Megjithatë, demokrati nga Virxhinia Perëndimore, Joe Manchin, arriti ta mbante vendin e tij në Senat dhe fitoi ndaj republikanit Patrick Morrisey, prokurori i përgjithshëm i këtij shteti. Parashikimet për kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit vijnë ndërsa qendrat e votimit janë mbyllur në gjithë vendin.

Demokratët siguruan fitoren e parë të rëndësishme në Virxhinia, në rrethinat e Uashingtonit, ku Jennifer Wexton, një prokurore dhe senatore e legjislaturës së shtetit, fitoi ndaj anëtares aktuale të Dhomës së Përfaqësuesve, Barbara Comstock.

Me humbjen e Comstock, një tjetër fitore demokrate në Florida, dy të tjera në Pensilvani dhe dy në Kolorado, si edhe disa në shtete të tjera, demokratët arritën ta marrin shumicën e Dhomës së Përfaqësuesve. Demokratja Donna Shalala, ish-sekretare e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale, fitoi ndaj republikanes Maria Elvira Salazar për një vend që mbahej nga anëtarja veterane republikane e Kongresit, Ileana Ros-Lehtinen nga Florida.

Balanca e pushtetit

Marrja e kontrollit të Dhomës së Përfaqësuesve nga demokratët për herë të parë që prej tetë vjetësh do të thotë se ata do të

jenë në gjendje ta fregojnë agjendën e presidentit republikan, Donald Trump. Por, jo vetëm kaq. Ata mund të hidhen në sulm, duke marrë drejtimin e komisioneve të rëndësishme që kanë kompetenca të gjera për hetime.

Disa demokratë kanë lënë të kuptohet se do të kërkojnë t'i shohin formularët e taksave të presidentit dhe t'i hetojnë financat e tij personale dhe interesat e biznesit, si dhe lidhjet e fushatës të tij presidenciale me Rusinë. "Është një kontroll kritik ndaj presidentit Trump. Legjislacione madhore me ngjyrimë ideologjike, nuk do të miratohen dy vjetët e ardhshëm. Demokratët kanë tani pushtet të thërrasin në pyetje, kështu që presidenti dhe administrata e tij mund të presin të hetohen, jo të mbrohen nga Dhoma e Përfaqësuesve", thotë analisti i Universitetit të Virxhinias, Larry Sabato.

Për çështje si imigracioni, për shembull, presidenti nuk do të jetë në gjendje të veprojë pa mbështetjen e demokratëve që kanë pak gjasa të bien dakord me të për këtë temë. Por ruajtja e

kontrollit të Senatit do të thotë se republikanët do të vazhdojnë ta kenë aftësinë të konfirmojnë të emëruarit në gjyqsor dhe kandidatura të tjera të Trumpit. Senati i kontrolluar nga republikanët mund të mos lejojë Kongresin ta shkarkojë presidentin Trump, nëse Dhoma e Përfaqësuesve e kontrolluar nga demokratët fillon procesin për shkarkimin e tij. Hera e fundit që ka pasur një ndarje të tillë të pushtetit, që demokratët morën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe republikanët Senatit, ishte në vitin 1986, në mandatin e dytë të presidentit Ronald Reagan.

Një numër rekord fitoresh nga kandidatet

Një numër rekord prej 237 grash kandiduan për Dhomën e Përfaqësuesve dhe 23 në garat për Senatit në gjithë vendin, përfshirë 185 demokratë dhe 52 republikanë.

Deri tani dihet se 92 gra kishin fituar në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 10 në Senat,

duke iu bashkuar 10 senatoreve aktuale, duke kapur një numër prej 112 grash anëtare të Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit, numri më i madh ndonjëherë në Kongres. Rekordi i mëparshëm ishte 107.

Gratë patën edhe disa arritje të tjera. Deb Haaland dhe Sharice Davids janë të parat gra nga indianët e Amerikës. Rashida Tlaib dhe Ilhan Omar janë të parat gra myslimane që do t'i përfaqësojnë shtetet e tyre në Dhomën e Përfaqësuesve. Dhe Alexandria Ocasio-Cortez dhe Abby Finkenauer janë gratë më të reja në moshë që shërbejnë ndonjëherë si ligjvënese.

Shumë prej tyre kandiduan në dy vjetët e fundit, të mobilizuara nga njoftimet për sjelljen e presidentit Donald Trump ndaj grave, lëvizjes #MeToo që ka hedhur dritë mbi përmasat e sulmeve seksuale dhe platformave të politikave republikane për çështje si e drejta e abortit. Por një nga garat më të rëndësishme për Senatit u fitua nga Marsha Blackburn, një mbështetëse e fortë e presidentit Trump në shtetin Tennesi.

Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë do ta mbështesë FSK-në me teknikë dhe personel



ZAGREB, 7 NËNTOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, Damir Krstičević, po qëndron për vizitë zyrtare në Zagreb. Ministri Berisha dhe ministri Krstičević kanë biseduar lidhur me situatën aktuale të sigurisë në të dy vendet, në rajon dhe më gjerë, si dhe për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy shteteve dhe dy ministrive përkatëse. Ministri Berisha e ka njoftuar

homologun Krstičević edhe mbi zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë mbi procesin e tranzicionit të FSK-së, procedurat ligjore dhe demokratike që po zbatohen në drejtim të përmbylljes së këtij procesi, krijimin e bazës ligjore për mandatin e ri të FSK-së, si dhe për detyrat që dalin pas votimit të tri projektligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ministri Berisha ka nënvizuar nevojën për avancimin e bashkëpunimit me Kroacinë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë,

si dhe ka shprehur mirënjohje të lartë për mbështetjen që ka dhënë shteti dhe populli kroat në rrugëtimin e Kosovës, duke veçuar sidomos fushën e edukimit dhe arsimit dhe atë të sigurisë dhe mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Damir Krstičević, ka rikonfirmuar gatishmërinë e Kroacisë për mbështetjen e gjithanshme të Kosovës, duke u zotuar se do ta mbështesë Kosovën në zhvillimin e kapaciteteve të saj të mbrojtjes me teknikë dhe personel.

Rinis procesi i dialogut në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Thaçi e Vuçiqi takohen sot në Bruksel

Me ndërmjetësimin e shefes për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, sot (e enjte) në Bruksel do të takohen presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Në këtë takim presidentët pritet ta konfirmojnë gatishmërinë e tyre për arritjen e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë se ky takim s'mund të jetë hyrje në fazën finale sepse, sipas saj, Kosova mund të marrë pjesë në finale të dialogut kur Kuvendi e autorizon delegacionin shtetëror. Edhe Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se është problematik fakti që Thaçi merr pjesë në bisedime përderisa Kosova nuk ka një platformë shtetërore për dialogun me Serbinë



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Sot (e enjte) presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të priten në takim të përbashkët nga shëfja për politikë të jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Sipas një njoftimi të lëshuar nga zyra e Mogherinit, presidentët në këtë takim do ta konfirmojnë gatishmërinë e tyre për arritjen e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. "Në takim dy liderët pritet ta konfirmojnë gatishmërinë e tyre për ta shtuar punën drejt arritjes së një marrëveshjeje ligjrisht të obligueshme për normalizimin gjithëpërfshirës, i cili është vendimtar për rrugët e tyre evropiane", është thënë në njoftim.

Para nisjes për në Bruksel për të marrë pjesë në këtë takim, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka përshkruar të vështirë takimin me homologun serb. Por, Thaçi ka thënë se arritja e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë është e domosdoshme. "Rrugës për në Bruksel për një takim tjetër të vështirë me homologun e Serbisë, por të domosdoshëm për ta arritur marrëveshjen përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse ligjore ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë. Vetëm kjo do ta hapë perspektivën e BE-së për vendet tona dhe do të sigurojë anëtarësimin në KB për Kosovën", ka shkruar Thaçi në "Twitter".

Ndërkohë ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në këtë takim presidenti Thaçi duhet t'i mbrojtë interesat e Kosovës duke mos lejuar që të hapet tema për territorin dhe kufijtë. "Presidenti i Kosovës, Thaçi, duhet t'i mbrojtë interesat e shtetit, kufijtë, territorin si dhe të mos lejojë që të hapen këto tema dhe, në qoftë se ka tendenca nga pala serbe, duhet t'i bëhet me dije se Serbia ka bërë gjenocid në Kosovë dhe vetëm njohja e pavarësisë së Kosovës mund të jetë një veprim që e bën Serbinë shtet evropian dhe kjo mund ta hapë kapitullin e marrëdhënieve paqësore. Përndryshe, çfarëdo pretendimi hegjemonist i Serbisë nuk çon te një marrëveshje në mes të dy shteteve", është shprehur ajo.

Tahiri ka theksuar se takimi i së enjtes nuk mund të jetë hyrje në fazën finale sepse, sipas saj, Kosova mund të marrë pjesë zyrtarisht në finale të dialogut vetëm kur Kuvendi e autorizon delegacionin shtetëror. "Konsideroj se ky takim nuk mund të jetë hyrje në fazën finale të dialogut sepse vetëm kur kalon një rezolutë dhe

Kuvendi e autorizon delegacionin e Republikës së Kosovës, atëherë Kosova mund të marrë pjesë zyrtarisht në dialogun e fazës finale. Disa herë kam apeluar që Kuvendi të nxjerrë një rezolutë me unitet të plotë në mbrojtje të kufijve të shtetit të Kosovës. Kështu që delegacioni autorizohet për ta mbrojtur Kushtetutën, territorin, integritetin territorial dhe kufijtë e shtetit. Ndërsa marrëdhëniet ndërfaqësore duhet të përcaktohen me të drejtën ndërkombëtare dhe me parimet evropiane", ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se dialogu në Bruksel nuk mund të vazhdojë pa autorizimin e Kuvendit. "Unë nuk besoj se edhe Bashkimi Evropian dhe vetë Mogherini duhet ta vazhdojnë dialogun pa një autorizim sepse edhe ajo duhet parë legjitimitetin e palëve. Mirëpo takimi i së enjtes mund t'i shërbejë ndonjë konsulte si parapërgatitje për fazën finale", ka thënë Tahiri.

Takimin e së enjtes e ka komentuar edhe menaxherja e projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi. Ajo ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është problematik fakti që Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur pas gjithë këtyre diskutimeve të afrovojë një rezolutë me anë të së cilës do ta prezantojë qëndrimin e Kosovës për këto bised-

ime. "Pra, presidenti Thaçi të enjten prapë shkon në këto bisedime, ndërsa Kosova nuk ka një platformë shtetërore për dialogun me Serbinë. Nuk ka një qëndrim unik mbi këtë proces dhe Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka formuluar qëndrimin dhe nuk i ka dhënë legjitimitet këtij procesi", ka theksuar ajo.

Krasniqi ka thënë se është shumë e rëndësishme që spektri politik të ulet dhe të bisedojë seriozisht për ndërtimin e platformës shtetërore për bisedimet. "Deri më tani nuk ka ndodhur një gjë e tillë dhe kjo është shqetësuese. Kërkojmë nga Kuvendi dhe nga partitë e përfaqësuara në Kuvend që të ulen së bashku dhe këtë platformë ta legjitimojnë me anë të një rezolute. Diskutimet rreth dialogut Kosovë - Serbi nuk duhet të jenë për konsum ditor apo reflektim i politikave ditore, por duhet ta reflektojnë qëndrimin afatgjatë të shtetit të Kosovës mbi këtë proces", është shprehur ajo, duke shtuar se mungesa e një konsensusi politik dhe një koordinimi në mes të institucioneve për dialogun mund t'i kushtojë Kosovës në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm. "Prandaj patjetër duhet një konsensus dhe një bashkërendim të institucioneve për të garantuar se Kosova në këtë proces është duke bërë çdo gjë për ta mbrojtur interesin e

shtetit dhe të qytetarëve. Kërkojmë që të ketë sa më shumë transparencë dhe insistojmë që partitë politike të ulen, të diskutojnë dhe pastaj të ndërtojnë një qëndrim unik shtetëror, një platformë shtetërore të Kosovës, ku përcaktohen temat, vijat e kuqe, ekipi negociues, afatet kohore, garancitë dhe pritshmëritë nga procesi i dialogut", ka deklaruar Krasniqi.

Sipas saj, dialogu është e vetmja mënyrë që Kosova t'i zgjidhë çështjet me Serbinë. "Kosova patjetër që duhet t'i thotë po dialogut, por institucionet e Kosovës dhe partitë politike duhet të jenë shumë më serioze në mënyrë që ta ndërtojnë qëndrimin unik të shtetit të Kosovës dhe ta artikulojnë atë pasi ky proces është i ndërlidhur edhe me perspektivën evropiane të vendit. Kosova duhet të dijë se çfarë pret nga ky proces dhe duhet të punojë për përmbyshjen e pritshmërive. Kosova duhet ta kërkojë njohjen nga ky proces, anëtarësimin në OKB, njohjen nga pesë vendet jonjohëse të BE-së dhe perspektivën e qartë evropiane. Kosova duhet të dalë nga ky izolim që është tani. Po ashtu, BE-ja duhet ta ridefinojë pozicionin e vet ndaj Kosovës, pra të mos ketë pozicion neutral, mirëpo ta njohë shtetin e Kosovës dhe t'i ofrojë perspektivën evropiane", ka theksuar Krasniqi.

Haradinaj: Kosova është e gatshme t'i marrë përgjegjësitë e veta si shtet



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të mërkurën në takim një delegacion francez, i kryesuar nga drejtoresha e Departamentit për Evropën Kontinentale të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Florence Mangin. Marrëdhëniet bilaterale dhe proceset integruese euroat-

lantike ishin në fokus të takimit që pati kryeministri me delegacionin francez.

Kryeministri Haradinaj gjatë këtij takimi ka theksuar se Evropa duhet parë Kosovën si konsumatore për ekonominë e saj dhe partnere kredibile për sigurinë rajonale e globale. "Kosova është e gatshme t'i marrë përgjegjësitë e veta si shtet, duke u

bërë pjesë aktive e organizatave ndërkombëtare. Në këtë etapë, presim mbështetjen e Francës për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët tanë, për të cilën i kemi përmbyshur të gjitha kriteret me kohë dhe mbështetjen për anëtarësim në Interpol, me rëndësi kyçe për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional", ka deklaruar Haradinaj.

Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

Pozita po përdorë dy s



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, i ka kritikuar subjektet e koalicionit qeverisës se po përdorin dy standarde në raport me dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto parti ndryshe po deklarohen në opinion rreth këtij procesi e ndryshe po veprojnë në Kuvendin e Kosovës. Sipas Kurteshit, nëse pozita dëshiron të tregojë se është kundër idesë së presidentit Hashim Thaçi për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi duhet ta votojë projektrezolutën e opozitës. Ndërkaq dialogun e dy presidentëve në Bruksel, deputeti Kurteshi e ka quajtur ilegal

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, i ka kritikuar subjektet e koalicionit qeverisës për qasjen e tyre ndaj dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka deklaruar se këto parti ndryshe po deklarohen rreth këtij procesi e ndryshe po veprojnë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kurteshi ka vlerësuar se pozita, nëse është kundër korrigjimit të kufirit, duhet ta votojë projektrezolutën e opozitës. "Kjo po ndodh sepse disa prej subjekteve politike të koalicionit qeverisës që janë pajtuar të mos

diskutohet asgjë rreth territorit të Kosovës, në të njëjtën kohë nuk po duan ta kundërshtojnë në praktikë idenë e presidentit Thaçi për korrigjimin e kufirit. Mendoj se subjektet politike të koalicionit qeverisës nuk duhet të luajnë me dy standarde me këtë çështje. Ata duhet të jenë kundër këmbimit të territoreve dhe ta votojnë rezolutën e cila e pamundëson këtë dialog", ka thënë Kurteshi. Ai ka arsyetuar mungesën e disa deputetëve të opozitës në ditën që është votuar për projektrezolutën, duke thënë se pa përkrahjen e partive të koalicionit qeverisës ajo projektrezolutë nuk mund të kalojë. Deputeti i Vetëvendosjes e ka

kritikuar presidentin e vendit për vazhdimin e fazës finale të dialogut me Serbinë pa pajtim të Kuvendit të Kosovës. Sipas Kurteshit, këto bisedime janë ilegale dhe si të tilla duhet të ndërpriten. "Mendoj se takimet e tillë janë ilegale dhe ato nuk kanë autorizim të Kuvendit. Kuvendi i Kosovës ende nuk ka platformë për këtë çështje, nuk ka pajtueshmëri të spektrit politik për këtë dialog dhe si të tilla këto bisedime nuk duhet të ndodhin. Të gjithë po deklarohen se janë kundër dialogut për terrorin e shtetit të Kosovës, kështu që këto bisedime duhet të trajtohen ashtu siç janë, pra ilegale. Ato janë vetëm bisedime

standarde për dialogun

"Epoka e re": Z. Kurteshi, projekt-rezoluta e opozitës për dialogun me Serbinë sërish nuk gjeti përkrahje në Kuvendin e Kosovës. Pse?

Kurteshi: Sepse disa prej subjekteve politike të koalicionit qeverisës që janë pajtuar që të mos diskutohet asgjë rreth territorit të Kosovës, në të njëjtën kohë nuk po duan ta kundërshtojnë në praktikë idenë e presidentit Thaçi për korrigjimin e kufirit. Mendoj se subjektet politike të koalicionit qeverisës nuk duhet të luajnë me dy standarde me këtë çështje. Ata duhet të jenë kundër këmbimit të territoreve dhe ta votojnë rezolutën e cila e pamundëson këtë dialog. Në të kundërtën i bie se ata po e mundësojnë një dialog të tillë i cili është tepër i dëmshëm për Kosovën.

"Epoka e re": Fajtorë po i bëni deputetët e pozitës, por ditën që është votuar në Kuvend ka pasur disa deputetë të LDK-së dhe të LV-së që nuk kanë marrë pjesë në votim.

Kurteshi: Fajtorë janë partitë në pushtet të cilat po deklarohen çdo ditë kundër këmbimit të territoreve, por atë nuk po e materializojnë përmes votës së tyre që është e domosdoshme që ta ndalë çdo kënd që pretendon të bisedojë për këtë çështje në dialogun me Serbinë. Mospjesëmarrja e disa deputetëve të opozitës në atë seancë është një çështje tjetër. Mungesa e tyre nuk do të thotë se ata nuk e përkrahin këtë rezolutë. Mendoj se mungesat e tyre kanë qenë të arsyeshme. E rëndësishme është se ata e përkrahin këtë rezolutë, por edhe sikur të ishin ata të pranishëm nuk mjaftojnë vetëm votat e pozitës për këtë çështje. Për të kaluar kjo rezolutë duhet të votojë patjetër edhe dikush nga pozita.

"Epoka e re": Në bazë të rrethanave të krijuara, ekziston ende vullneti te pozita dhe opozita që të arrihet një konsensus kombëtar rreth kësaj çështje?

Kurteshi: Opozita e ka nënshkruar çështjen e rezolutës dhe nuk vihet në dyshim vullneti i këtyre subjekteve që janë kundër bisedimeve për territor, kurse pozita po deklarohet njësoj sikurse pozita, por nuk po vepron ashtu siç po deklarohet.

"Epoka e re": Tashmë është konfirmuar takimi i radhës në mes të presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë, i cili pritet të ndodhë këtë të enjte, ndërsa Kuvendi

ende nuk ka hartuar asnjë platformë për këto bisedime?

Kurteshi: Mendoj se takimet e tillë janë ilegale dhe ato nuk kanë autorizim të Kuvendit. Kuvendi i Kosovës ende nuk ka platformë për këtë çështje, nuk ka pajtueshmëri të spektrit politik për këtë dialog dhe, si të tilla, këto bisedime nuk duhet të ndodhin. Të gjithë po deklarohen se janë kundër dialogut për terrorin e shtetit të Kosovës, kështu që këto bisedime duhet të trajtohen ashtu siç janë, pra ilegale. Ato janë vetëm bisedime të Hashim Thaçit me Serbinë, por jo të spektrit politik shqiptar të Kosovës. Asnjë parti shqiptare nuk është deklaruar se është për këmbim të territoreve.

"Epoka e re": Nëse nuk mund të arrihet një konsensus kombëtar për këtë çështje, si duhet të vepron për të ecur përpara?

Kurteshi: Duhet të bëjmë përp-

jekje që kjo rezolutë të vijë sa më shpejt në Kuvend dhe t'u bëjmë apel deputetëve të pozitës për ta votuar atë. Nëse një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë duhet të mendojmë për hapat e ardhshëm të cilët janë në funksion të pengimit të dialogut me Serbinë për territore.

"Epoka e re": Zgjedhjet e reja do të mund ta ndalin këtë proces?

Kurteshi: Mendoj se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. Neve na mungojnë tri-katër vota për ta realizuar një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë, në mënyrë që vendin ta çojmë në zgjedhje të reja. Qeveria aktuale nuk është qeveri e shumicës dhe nuk i ka votat e mjaftueshme për ta qeverisur vendin. Kjo qeveri çdoherë po varet nga opozita, në të njëjtën kohë nuk është e gatshme të bashkëpunojë për çështje shumë të rëndësishme me opozitën siç është tema për

të cilën biseduam më lart.

"Epoka e re": Si do ta siguron mbështetjen e nevojshme në Kuvend për ta rrëzuar Qeverinë?

Kurteshi: Mendoj se kjo do të arrihet duke i bindur deputetët e pozitës që kjo Qeveri nuk është e zonja t'i kryejë punët e veta si duhet dhe, si e tillë, po i shkakton dëme vendit. Nga kjo kuptojmë se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje ngaqë përmes tyre do të formohej një qeveri e shumicës.

"Epoka e re": Deri më tani jua ka dhënë ndokush prej deputetëve të pozitës ndonjë sinjal se mund t'ju përkrahë në këtë drejtim?

Kurteshi: Nuk mund të them se ka dhënë dikush prej tyre sinjale se do të mund ta mbështesë mocionin e opozitës. Së paku unë nuk kam biseduar me asnjë deputet të pozitës për këtë çështje.

Kosova i kërkon ShBA-së mbështetje për anëtarësim të plotë në Interpol

PRISHTINE, 7 NËNTOR - Kosova u ka kërkuar mbështetje për anëtarësim me të drejta të plota në Interpol Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, gjatë vizitës në ShBA ka pasur në Uashington një takim me prokurorin e përgjithshëm amerikan, Jeff Sessions, me të cilin ka diskutuar për këtë dhe tema të tjera. "Për mua si ministër i Drejtësisë së Kosovës ishte një takim shumë i rëndësishëm me z. Sessions. Temat që kemi diskutuar me të kanë qenë fuqizimi i sundimit të ligjit edhe më tej në Kosovë. E kam informuar për reformat që kam ndërmarrë tash e 14 muaj si ministër

i Drejtësisë, për angazhimin tim të përbashkët së bashku me agjencitë që janë në Republikën e Kosovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç janë OBDAT, ICITAP, INL. Një nga temat më të rëndësishme që kam kërkuar diskutim me z. Sessions ka qenë përkrahja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën në agjendën e Interpolit. Pra, më 20 nëntor do të mbahet takimi, ku ne shpresojmë se do të bëhemi anëtar me të drejta të plota si Kosovë. Pa dyshim se kam marrë përkrahje të plotë nga z. Sessions se ShBA-ja do të vazhdojë të punojë fuqishëm dhe të sigurojë vota të tjera për

Kosovën në mënyrë që të bëhemi anëtar me të drejta të plota të kësaj organizate që është shumë e rëndësishme", ka thënë ministri Tahiri në një intervistë për "Zërin e Amerikës". Tahiri ka shtuar se Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje që t'i hapë rrugën perspektivës evropiane të dy vendeve. "Mendoj se është shumë e rëndësishme që Kosova dhe Serbia duhet të fillojnë një fazë të re të bisedimeve që do të arrijnë në një marrëveshje përfundimtare sepse kështu e kërkon edhe strategjia e Bashkimit Evropian që u publikua në prill të këtij viti", ka thënë ministri Tahiri.



të Hashim Thaçit me Serbinë", është shprehur deputeti Kurteshi. Ai ka bërë me dije se zgjidhja më e mirë për vendin do të ishin zgjedhjet e reja por, sipas tij, opozita ende nuk i ka numrat e mjaftueshëm për ta rrëzuar Qeverinë përmes mocionit të mosbesimit. "Mendoj se kjo do të arrihet duke i bindur deputetët e pozitës që kjo Qeveri nuk është e zonja t'i kryejë punët e veta si duhet dhe, si e tillë, po i shkakton dëme vendit. Nga kjo kuptojmë se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje ngaqë përmes tyre do të formohej një qeveri e shumicës", është shprehur Kurteshi.

Jo vetëm mjekë specialistë, por edhe ata familjarë po ikin nga Kosova

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Ikja e stafit mjekësor po paraqitet si një problematikë dhe shqetësim në Kosovë në dy vjetët e fundit. Arsyet e ikjes së këtij stafi, kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian, ku prin Gjermania, ndërliken me pagat dhe kushtet më të mira për punë. Gjatë këtij viti nëntë punëtorë shëndetësorë, dy mjekë dhe shtatë infermierë, vetëm nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në Komunën e Prishtinës e kanë lëshuar punën për të shkuar në vendet e Bashkimit Evropian, më konkretisht në Gjermani. Ndonëse një mjekë familjar është i paraparë për dy mijë pacientë, kjo nuk po mund të zbatohet për shkak të mungesës së stafit. Këta mjekë janë shumë më të ngarkuar me punë si rrjedhojë e mungesës së stafit shëndetësor. Sipas zyrtarëve shëndetësorë, janë mbi dy

milione shërbime mjekësore që kryhen brenda një viti në Qendrat e Mjekësisë Familjare vetëm në Komunën e Prishtinës. Ndërkaq, mbi pesë mijë shërbime marrin pacientët brenda 24 orëve në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare në gjithë Komunën e Prishtinës.

Sami Uka, kryeshef në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se është shqetësues fakti që mjekët po ikin, përfshirë edhe mjekët familjarë, por vendet e tyre nuk po plotësohen. Po ashtu, ai ka theksuar se numri i mjekëve familjarë, edhe i infermierëve nuk është rritur që nga paslufta, derisa numri i banorëve në Prishtinë është shumëfishuar. "Qendrat e Mjekësisë Familjare normalisht se e kanë ndier këtë fluks të ikjes së punëtorëve shëndetësorë, kryesisht në drejtim të



Gjermanisë. Kemi pasur kërkesa për mjekë e infermierë që të lirohen nga puna për të ikur atje. Trendi edhe për neve, por edhe për gjithë ata që marrin vesh në zhvillimet shëndetësore të Kosovës, është shqetësues. Ne kemi mungesë, por ka edhe mjekë familjarë të papunë. Aktualisht ka mungesë stafi edhe

pa ikjen e këtyre të fundit, por që numri i mjekëve specialistë, por edhe infermierëve nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare, nuk është rritur kohë të gjatë", ka deklaruar Uka.

Besim Kodra, i cili udhëheq Asociacionin e të Drejtave të Pacientëve, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se cilësia e shër-

bimeve shëndetësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare, ashtu sikurse edhe në gjithë sistemin shëndetësor të Kosovës, nuk është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, ai ka potencuar faktin se nga ana e pacientëve marrin ankesa më pak nga Qendrat e Mjekësisë Familjare sesa nga qendra shëndetësore dytësore dhe tretësore.

Në Qendrat e Mjekësisë Familjare, sipas një pilotprojekti që po zbatohet aktualisht, pacientët mund të bëjnë vizita mjekësore vetëm pasi t'i kenë caktuar ato paraprakisht. Sipas mjekëve familjarë, kjo nuk vlen për rastet emergjente. Sipas të dhënave që i ka prezantuar Federata Sindikale e Shëndetësisë për numrin e mjekëve specialistë që kanë ikur nga Kosova, që nga hulumtimi i fundit i bërë në Kosovë, ka qenë mbi 400.

Bëhet dorëzimi i dekoratave 'Heroi i Kosovës' për familjarët e 158 heronjve



SKENDERAJ, 7 NËNTOR (ER) - Në Komunën e Skenderajt të mërkurën është organizuar ceremonia e ndarjes së medaljeve për 158 heronjtë dhe dëshmorët të cilët më 6 tetor të këtij viti janë shpallur heronj të Kosovës nga presidenti Hashim Thaçi në përurimin e Kompleksit Memorial në Marinë. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar presidentin Thaçi që

ka dekoruar këta dëshmorë, edhe pse ky i fundit nuk ka qenë i pranishëm në këtë ceremoni. Jashari në fjalën e tij ka thënë se ndien dhimbje të barabartë me të gjithë familjarët e dëshmorëve, në të njëjtën kohë ai ka theksuar se janë krenarë që janë familjarë të dëshmorëve. "Ne e kemi bërë një punë pas 20 vjetësh bashkërisht me juve, një punë që e kemi pasur për obligim ta bëjmë si institucion.

Dhëntë Zoti që ne të mbledhim mend dhe si qytetarë e si popull, të jemi të bashkuar dhe ta ndërtojmë këtë vend, ta zhvillojmë ekonomikisht. Vetëm atëherë mund të themi se po jetësohet amaneti i dëshmorëve, duke zhvilluar vendin që qytetarët, e sidomos rinia e këtij vendi, ta shohë veten në vendin e vet", ka thënë Jashari.

Në emër të presidentit Thaçi ka folur këshilltari i tij, Ismajl Sylja, i

cili ka thënë se po përfundohet një punë që kishte nisur më 6 tetor në Marinë. "Kjo ceremoni, në fakt është vazhdim i 6 tetorit në Marinë, me ç'rast bëhet dorëzimi i urdhrit 'Hero i Kosovës' për të gjithë dëshmorët të cilët kanë rënë në betejat e luftës së UÇK-së. Një gjë duhet ta keni parasysh, ju keni dhënë njerëzit më të shtrenjtë dhe ata njerëz qëndrojnë në rrënjët e lirisë dhe të Kosova e sotme.

Ndërkaq, shteti dhe institucionet e bëjnë ose nuk e bëjnë më së miri detyrën e Kosovës, por ju të nderuar familjarë duhet vetë ta dini se ju jeni njerëzit më ballëhapur që rriini përballë atdheut", është shprehur ai. Ndërsa nënkryetari i Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, Migjen Shala, ka thënë se ushtarët e trevës së Drenicës janë përballur me beteja e luftëra të ndryshme për ta mbrojtur atdheun.

Më 16 nëntor Kuvendi mblidhet në seancë të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mblledhjen e mbajtur të mërkurën, të drejtuar nga Kadri Veseli, kryetar, në të cilën kanë marrë pjesë edhe

kryetarët e grupeve parlamentare, ka shqyrtuar kërkesën e 42 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dësh-

timet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës. Në përputhje të kërkesës, kryesia vendosi që Kuvendi të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme

më 16 nëntor, në orën 10:00, për shqyrtimin e kësaj pike. Në mblledhjen e së mërkurës kryesia shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.



Veseli: Mosliberalizimi i vizave është racizëm i skajshëm

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë të mërkurën se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave. Sipas tij, në rast se Bashkimi Evropian (BE) nuk i liberalizon vizat për qytetarët e Kosovës, ky do të ishte racizëm i skajshëm

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të mërkurën se të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave janë përmbushur dhe se në rast se Bashkimi Evropian nuk i liberalizon vizat për qytetarët e Kosovës, atëherë ky do të ishte racizëm i skajshëm.

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Veseli ka thënë se nuk do të ndalet së lobuari për liberalizimin e vizave dhe se në të njëjtën kohë do të jetë edhe më i zëshëm në të drejtën e qytetarëve të Kosovës për të lëvizur pa viza në Evropë. "Shikoni krahasimin me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova qëndron shumë më mirë qoftë në aspektin e respektimit të shtetit ligjor apo në atë ekonomik. Nuk duhet të lejohet askush të na privojë nga e drejta që na takon. Qëndrimi im politik është ky: ky është racizëm, racizëm i skajshëm", ka deklaruar Veseli.

Këshilli i Bashkimit Evropian pritet që në dhjetor të vendosë për ose kundër liberalizimit të vizave për Kosovën. Disa shtete kanë shprehur skepticizëm nëse

Kosovës duhet t'i ofrohej liberalizimi i vizave. Këtë e ka konfirmuar të martën gjatë vizitës në Prishtinë edhe kancelari austriak Sebastian Kurz, vendi i të cilit mban kryesimin aktual të Bashkimit Evropian. Ai ka thënë se ende ekziston një skepticizëm te vendet anëtare lidhur me procesin e liberalizimit të vizave.

Zëvendësministri i Integritimit Evropian, Lirak Çelaj, në një intervistë dhënë këto ditë për gazetën "Epoka e re", ka shprehur optimizëm se Bashkimi Evropian brenda këtij viti do ta marrë vendimin për liberalizim të vizave për Kosovën. Ai ka bërë me dije se deri më tani asnjëri prej vendeve kryesore të BE-së nuk ka thënë se është kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. "Qeveria e Kosovës i ka përmbushur të gjitha obligimet teknike që janë kërkuar nga BE-ja për procesin e liberalizimit të vizave. Ndërsa tash është një vendim politik i BE-së për të cilin disa vende anëtare të BE-së mund të kenë edhe hamendje politike, prandaj ne duhet të jemi korrektë dhe duhet t'u shmangemi datave apo ta paragjykojmë vendimin e BE-së. Kjo nuk do të thotë se ne



jemi skeptikë për këtë vendim. Pra, ky është një vendim politik ku mund të ndikojnë shtetet e caktuara në këtë vendim për

arsye të ndryshme, por ne si Qeveri jemi në pritje të këtij vendimi dhe shpresojmë se do të jetë pozitiv. Shpresoj dhe

besoj se brenda këtij viti, pa specifikuar ndonjë muaj, do të ketë një vendim pozitiv të BE-së për këtë çështje", ka thënë Çelaj.

Kuvendi miratoi rezolutën për shtesa të fëmijëve dhe projektligjin për referendumin

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Me 61 vota për, një kundër dhe dy abstenime është miratuar të mërkurën propozimrezoluta nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë deputetë nënshkrues nga grupi parlamentar i AAK-së në lidhje me shtesat e fëmijëve.

Më 15 tetor kishte filluar debati parlamentar, ku ishte propozuar që çdo fëmijë në Kosovë prej 0 deri 16 vjet të gëzojë shtesa çdo muaj duke filluar nga 10 euro në muaj. Ndarja e shtesave për fëmijë do të fillojë nga viti 2019. Po ashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për referendum. Në favor të këtij projektligji kanë votuar 49 deputetë, 6 kundër dhe 6 kanë abstenuar.

Propozues i projektligjit ishte Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate dhe, sipas deputetit Faton Topalli, projektligji parasheh tri lloje të referendumit:

referendumin shfuqizues, i cili mundëson shfuqizimin e një ligji ose një pjese të tij; referendumin konsultativ, i cili inicohet nga presidenti ose kuvendi dhe përmes tij kërkohet mendimi i qytetarëve për ndonjë çështje të caktuar, si dhe referendumin kushtetues, përmes të cilit kuvendi mund të organizojë referendum për ndryshime kushtetuese, duke përfshirë edhe dy të tretat e minoriteteve dhe vendeve të rezervuara. Sipas deputetit Topalli, Partia Socialdemokrate vlerëson se projektligji për referendumin është instrument kundër "kapjes së shtetit, monopoleve ekonomike dhe politike, si dhe shkeljes së të drejtave të njeriut".



Në këtë seancë është tërhequr nga pika e rendit të ditës votimi i propozimrezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të

Kosovës, Hashim Thaçi, për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas heqjes së kësaj

prike nga rendi i ditës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje e kanë lëshuar seancën e rregullt të Kuvendit të Kosovës.

Klubi i Prodhuesve, memorandum bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka nënshkruar të mërkurën një memorandum bashkëpunimi së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës për promovimin e eksportit dhe tërheqjen e investimeve të huaja që kanë për synim rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve prodhuese kosovare dhe ekonomisë ven-

dore.

Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, është shprehur i kënaqur me fillimin e këtij bashkëpunimi në mes të këtyre dy institucioneve. "Ne si Klub i Prodhuesve e shohim Odën si institucionin më të lartë ekonomik i cili duhet ta shtyjë përpara fuqizimin e prodhimit në vendin tonë. Ne do të jemi

aleatë dhe bashkëpunues për prezantimin e Kosovës si një vend në të cilin mund të investohet. Bashkërisht me Odën Ekonomike do t'i shfrytëzojmë rrjetet tona për promovimin e eksportit si në vendet e Bashkimit Evropian, ShBA dhe në Lindje të Mesme", ka deklaruar Panxha.

Ndërsa kryetari i Odës

Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka theksuar se ky memorandum është fillimi i një bashkëpunimi të përbashkët për të krijuar kushte më të mira për kompanitë vendore. "Me angazhime konkrete do të mundohemi që së bashku ta bëjmë promovimin e investimeve dhe eksportit si dhe krijimin e vendeve të reja të punës",

ka thënë Rukiqi.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të memorandumit të dyja palët e përkrahën vendimin e djeshëm të Qeverisë së Kosovës për miratimin e vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina t'u vihet taksë prej 10 përqindësh.

Lluka: Kosova dhe Greqia do ta rrisin bashkëpunimin ekonomik



PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të mërkurën në takim sekretarin e përgjithshëm për çështjet ekonomike ndërkombëtare dhe bashkëpunim për zhvillim në Ministrinë e Punës së Jashtme të Greqisë, Ioannis Brachos, i shoqëruar me një delegacion të shtetit grek.

Në takim u diskutuan mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik të dy vendeve, rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional,

rritjes së shkëmbimit tregtar dhe shkëmbimit të përvojave të mira në fushën e zhvillimit ekonomik. Ministri Lluka me këtë rast ka njoftuar delegacionin grek me zhvillimet ekonomike në vendin tonë, projektet kapitale dhe synimet e Kosovës për krijimin e klimës për tërheqjen e investitorëve të huaj, e sidomos në fushën e IT-së, energjisë dhe metalurgjisë. Po ashtu, i pari i MZHE-së foli për rëndësinë e Agjendës së Konektivitetit në mes të vendeve të

Ballkanit Perëndimor drejt krijimit të një zone të përbashkët ekonomike.

Ministri Lluka ka njoftuar delegacionin e shtetit grek për projektin e parkut inovativ në Prizren. "Kosova synon të bëhet qendër rajonale për zhvillim të sektorit të teknologjisë informative", ka thënë ministri Lluka, duke premtuar se bizneset kosovare do të jenë të pranishme në Forumin Ekonomik që do të mbahet në Athinë në fillim të vitit të

ardhshëm dhe që ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ekonomik.

Ndërsa sekretari grek për çështjet ekonomike, Brachos, duke falënderuar ministrin Lluka për pritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim, ka theksuar se Greqia është e gatshme të ngrehë në një nivel më të lartë bashkëpunimin ndërshtetëror për të gjitha çështjet të cilat do të ndihmonin në zhvillimin ekonomik të dy vendeve. "Ne jemi këtu për t'i parë mundësitë e

rritjes së bashkëpunimit ekonomik në mes dy vendeve. Ne duam që bashkëpunimi i deritashëm të shkojë në një nivel tjetër që do ta rriste shkëmbimin tregtarë të dy vendeve, do t'i shkëmbejmë përvojat e mira ekonomike dhe t'i rrisim investimet e dyanshme", është shprehur sekretari i përgjithshëm për çështjet ekonomike ndërkombëtare dhe bashkëpunim për zhvillim në Ministrinë e Punës së Jashtme të Greqisë, Ioannis Brachos.

Shala: Masa mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja do të mbetet në fuqi



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Kosova ka qenë e obliguar të ndërmarë masa ndaj importeve të shtetit të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës në mënyrë që t'i mbrojë prodhuesit vendorë. Sipas tij, kjo masë do të mbetet në fuqi deri në ndërrimin e qasjes së Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës ndaj Kosovës

dëmtuar dhe kanë vazhduar t'i dëmtojnë prodhuesit vendorë dhe ekonominë e Kosovës. Unë si ministër i MTI-së i kam propozuar Qeverisë së Kosovës marrjen e kësaj mase mbrojtëse dhe Qeveria ka marrë masën dhe është në fuqi", ka thënë ministri Shala.

Pavarësisht prej presionit të BE-së për ta shfuqizuar këtë masë, ministri Shala beson se Qeveria nuk do të tërhiqet nga vendimi i saj. "Besoj dhe shpresoj se Qeveria do të vazhdojë ta mbajë këtë masë", ka thënë Shala. Ai ka shtuar se përfundimisht Serbia dhe Bosnjë Hercegovina duhet ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës dhe prodhuesve vendorë. Shala ka thënë se Qeveria e Kosovës është e interesuar të ketë raporte të mira me të gjitha shtetet, duke mos përjashtuar edhe Serbinë e Bosnjë Hercegovinën por, sipas tij, këto dy shtete duhet ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës. "Si Kosovë jemi të interesuar të krijojmë raporte të mira me të gjithë fqinjët, qoftë edhe me Serbinë dhe Bosnjën, por duhet të përfundojë qasje e deritanishme që kanë pasur Serbia dhe Bosnjë

Hercegovina ndaj Kosovës dhe bizneseve tona. Tani masa mbrojtëse është në domenin e Qeverisë së Kosovës. Besoj se do të vazhdojë edhe më tutje", ka thënë Shala.

Vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina e kanë mirëpritur asociacionet më të mëdha të bizneseve në vend, si Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca Kosovare e Bizneseve dhe Klubi i Prodhuesve të Kosovës.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës e kanë përkratur vendimin e Qeverisë së Kosovës që produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina t'u vihet taksa prej 10 përqindësh. Edhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) e ka vlerësuar pozitivisht këtë vendim. "AKB-ja vazhdimisht ka bërë thirrje dhe rekomandime për të marrë vendime të guximshme, por të domosdoshme për ta mbrojtur prodhimin vendor dhe tash kjo masë mbrojtëse do ta rrisë prodhimtarinë vendore si asnjëherë më parë, kurse kom-

panitë tregtare mund t'i zëvendësojnë importet nga vendet e tjera, duke mos lënë konsumatorët ta ndiejnë mungesën e produkteve dhe ashtrenjtimin e tyre. Institucionet vendore do të kenë presion ndërkombëtar për një vendim të tillë, por Serbia asnjëherë nuk ka pasur presion ndërkombëtar të duhur për t'i respektuar marrëveshjet në raport me Kosovën", është theksuar në komunikatën e AKB-së. Edhe Shoqata e Qumështarëve ka mirëpritur këtë vendim të MTI-së. "Ne kemi ngritur disa herë zërin ndaj pabarazisë së tregtisë me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën dhe jemi të gëzuar që zëri ynë më në fund është dëgjuar. Falënderojmë ministrin Shala për angazhimin që ka treguar kohët e fundit në këtë drejtim dhe presim edhe vendime të tjera me qëllim mbrojtjen e produkteve vendore. Me këtë rast u bëjmë thirrje edhe institucioneve të tjera përgjegjëse për rregullimin dhe kontrollin e tregut që ta kryejnë obligimin e vet ligjor dhe të na krijojnë hapësirë për punë", është thënë në komunikatën e Shoqatës së Qumështarëve.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen mbajtur të martën ka vendosur masë mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina. Masa mbrojtëse nënkupton taksën prej 10-përqindësh të të gjitha produkteve që importohen në Kosovë dhe kanë për vend të origjinës Serbinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën. Përjashtim nga kjo masë do të bëjnë produktet e brendeve ndërkombëtare të prodhuara në këto dy vende.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, në një deklaratë për gazetën

"Epoka e re" ka theksuar të mërkurën se Qeveria e Kosovës ka qenë e obliguar që të ndërmarë masa ndaj importeve të shtetit të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës në mënyrë që t'i mbrojë prodhuesit vendorë dhe që mos të falimentojnë bizneset vendore. "Si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë, duke parë atë se si Serbia dhe Bosnjë Hercegovina po sillen për sa kohë me Republikën e Kosovës, në këtë rast se si ata përdorin masa për t'i mbrojtur produktet e tyre që i importojnë në Kosovë, morëm vendimin për masën mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina. Në vazhdimësi Serbia dhe Bosnjë Hercegovina e kanë

Komuna e Mitrovicës vazhdon të ofrojë mbështetje për komunitetet pakicë

MITROVICË, 7 NËNTOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të mërkurën në një takim pune drejtorin e Qendrës së Dokumentimit për Romë dhe Ashkali, Bekim Sylja, dhe koordinatorin e kësaj qendre, Dritan Shaipi. Qëllimi i këtij takimi ishte që të realizohet projekti "Programi global për hapësira publike" nga Qendra e Dokumentimit për Romë dhe Ashkali (RAD Center) në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës.

Në këtë takim është diskutuar për problemet dhe nevojat e romëve dhe të komunitetit në përgjithësi si dhe për mundësitë për t'i kapërcyer ato. Prej problemeve më të mëdha me të cilat ky komunitet ballafaqohet janë papunësia, kanalizimi dhe ndriçimi i rrugëve.

Nën kryetari i komunës, Faruk

Mujka, ka theksuar se komuna po përpiqet të jetë e hapur për qytetarët dhe ta afrojë institucionin sa më afër me komunitetet. Nën kryetari Mujka ka parashtruar edhe disa nevoja të këtyre komuniteteve të cilat mund të realizohen përmes këtij projekti. Në vazhden e bisedës ai ka përmendur krijimin e disa këndeve të lojërave për fëmijë të cilat janë shumë të nevojshme te Liqeni Artificial si dhe rregullimin e gypave të kanalizimit. Po ashtu, nënkryetari Mujka ka thënë se duke u bazuar në komunikimet e deritanishëm që kanë pasur me përfaqësuesit e komunitetit romë dhe për përcaktimin e problemeve, Komuna e Mitrovicës ka ndihmuar realizimin e projekteve për ndërtimin e shtëpive sociale, asfaltimin e rrugëve, funksionimin e ambulantes si dhe në largimin e mbeturinave.



Bashkë me britanikët, për punësim meritator

PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Në vazhden e angazhimit kundër korrupsionit, kundër nepotizmit dhe për qeverisje transparente, kryetari i kryeqytetit, Shpend Ahmeti, ka nënshkruar të mërkurën memorandum mirëkuptimi me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell. Memorandumi ka për qëllim avancimin e strukturave publike me qëllim të fuqizimit të transparencës, profesionalizimit dhe përgjegjshmërisë.

Synim i veçantë i këtij memorandum është pavarësia dhe profesionalizmi në procesin e rekrutimit për pozitave të larta drejtuese në ndërmarrjet publike. "Kësisoj, përmirësohet tutje kapaciteti i ndërmarrjeve

publike për të kontribuar në arritjen e reformave sfiduese, duke krijuar më shumë mundësi profesionale, politikëbërje të përgjegjshme dhe transparente, si dhe të rritet besimi në ndërmarrjet publike. Në terma konkretë, qëllimi i projektit është që të sjellë një standard të ri dhe më të avancuar në proceset e rekrutimit të pozitave publike", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Më tutje, në këtë njoftim theksohet se një partner zbatues i zgjedhur nga Ambasada e Britanisë do ta ndihmojë kryeqytetin për rekrutimin e pozitave të larta në ndërmarrjet publike, duke ndihmuar në parandalimin e nepotizmit dhe forcimin e transparencës, meritokracisë

dhe qeverisjes së mirë. "Pas çdo procesi rekrutues, partneri zbatues do të sugjerojë një listë të ngushtë të kandidatëve, e cila do të merret parasysh nga komisioni relevant. Përzgjedhja e njërit prej kandidatëve të listës së ngushtë do të bëhet nga ndërmarrja relevante/Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës zotohet se do ta lehtësojë zbatimin e projektit dhe do të sigurojë që partneri zbatues të ketë qasje të plotë në procesin e rekrutimit të pozitave të miratuara, qasje të plotë në informatat e domosdoshme", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Memorandumi i nënshkruar do të jetë në fuqi deri më 31 mars të vitit 2020.

Kadriu dhe Jashari merren vesh që punimet për përfundimin e rrugëve të vazhdojnë

SKENDERAJ, 7 NËNTOR (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, ka realizuar vizitë në Komunën e Skenderajt, me ç'rast është pritur nga i pari i Skenderajt, Bekim Jashari, me të cilin kanë diskutuar lidhur me zbatimin e projekteve rrugore nga Klina e Epërme-Skenderaj-rrethrotullimi në Marinë.

Zëvendësministri Kadriu e kryetari Jashari inspektuan punimet dhe biseduan me pronarët e tokave që momentalisht janë duke e penguar realizimin e projekteve rrugore. Duke ua sqaruar procedurën, Kadriu e Jashari u morën vesh me banorët që brenda tre muajsh ta



kompletojnë dokumentacionin për parcelat kontestuese në mënyrë që punimet të mos pengohen dhe këto rrugë me rëndësi edhe për vetë banorët të përfundohen sa më parë që të

jetë e mundur. Kadriu e Jashari u prematuan banorëve se asnjë pronar nuk do të mbetet pa u shpronësuar dhe asnjë kërkesë e tyre e arsyeshme nuk do të injorohet.

Tentimvrasje në Gjakovë

GJAKOVË, 7 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka pranuar një rast, i cilësuar si tentimvrasje. Rasti ka ndodhur më 31.

10. 2018 në fshatin Dujakë, Komuna e Gjakovës, ku i pandehuri A. J., pas një mosmarrëveshje të mëherëshme me të dëmtuarin S. A. nga fshati Dujakë, me dashje ka tentuar ta privojë nga jeta. Të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore me armë zjarri, ku gjithashtu lëndime të lehta trupore i ka shkaktuar edhe djalit të dëmtuarit B. A.

I pandehuri A. J. nga momenti i



rastit kritik është arratisur, duke u vetëparaqitur në polici në mënyrë vullnetare më 5. 11. 2018. Prokuroria Themelore në Gjakovë, pas marrjes së kallëzimit penal dhe analizimit të tij, më 6. 11. 2018 ka bërë kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, për caktimin e masës së paraburgimit në afat prej një muaji ndaj të pandehurit A. J., ku të njëjtit i është shqiptuar kjo masë.

Përrurim

Letrat e burgut si tekste letrare

(Martin Çuni, "Lulet e jetës", "Shkrola", Prishtinë, 2018)

Sadik KRASNIQI

Na ka rënë shumë t'i dëgjojmë rrëfimet e të burgosurve e t'i lexojmë letrat e burgut. Na ka rënë shumë të dëgjojmë e të lexojmë të tilla gjëra, ngaqë shumë ka pasur të burgosur politikë në regjimin, shtetin e sistemin komunist të Jugosllavisë. Një ndër ta është edhe njëri këtu, në mesin tonë, librin e të cilit me kënaqësi do ta hapim në këtë ambient të bukur letrar.

Ky është poeti, shkrimtari e, para së gjithash, atdhetari i madh Martin Çuni, me librin "Lulet e jetës" ("Shkrola", Prishtinë, 2018).

Nuk u vura theks rastësisht rrëfimeve gojore e shkrimore për burgun nga të përvuajturit. Rrëfimi i Martin Çunit për jetën në burg është shumë i veçantë, është i qartë, pa ndonjë emfazë dhe si i tillë tejet i dinjitetshëm si vetë qëndrimi i tij shumëvjeçar në këto burgje. Ky dinjitet, njerëzor, intelektual, edukativ e estetik përcillet edhe në letrat e këtij libri.

Tashmë në letërsinë shqipe kemi disa libra me tematikë nga burgu.

Vetë ambienti, rrethanat, atmosfera e burgut sikur determinon titujt uniformë të këtyre librave, sidomos të atyre librave që janë shkruar në formë letre.

Andaj edhe ky libër, hipotetikusht do të emërohej si letra nga burgu, letra nga qelia, letra nga vetmia, letra nga errësira apo edhe letra nga vetë ferri, nga se i tillë ishte burgu politik, por ky krijues na befason me një titull aq të bukur e metaforik "Lulet e jetës".

Në librin "Lulet e jetës" janë të përfshira letrat autoriale dërguar fëmijëve të tij Agronit e Teutës. Këto letra janë të ndryshme dhe kanë shumësi kuptimësie.

Duke qenë se kanë vulën e kohës së viteve nga maji 1983 deri të gushti 1989 si dhe e vendeve, burgu i Prishtinës, Prokupjes e atij të Nishit, këto letra kanë vlerë dokumentariteti. Shumëkuptimësia e tyre qëndron edhe në nuancat edukative, informative, arsimore e estetike.

Ky variacion shkrimor del i tillë nga se janë shkruar nga prindi, mësuesi, gazetari e shkrimtari, Martin Çuni.

Prindërorja në këto letra është e ndjeshme e përmallshme dhe nostalgjike.


Agron, fotografitë tuaja i kam marrë, u gëzova shumë kur ju pashë të fotografuar bukur. Shpesh po i shikoj ato fotografi të bukura, vërtet të bukura.

More, ishit rritur e bërë të mëdhenj, shprehet në një nga letrat e dërguara bijve apo "luleve të jetës" si i quan Martini fëmijët që rriteshin pa i parë.

Elementi edukativ e arsimor, për njohuri të reja përcillet përmes shembujve dhe këshillave nga shkenca po edhe nga përvoja, që përshkruhen në këto letra dedikuar dy fëmijëve.

E bukura e të shkruarit të këtyre letrave me stil të lartë, gjuhë të pasur e të figurshme me një strukturë të qartë e të kujdesshme sintaksore i bën këto të jenë letra me vlerë të lartë estetike, e si të tilla të lexohen si letërsi.

Letrat e këtij libri janë letra të ndryshme, përgjithësisht janë letra komunikuese, por në mesin e tyre hasim edhe rrëfime

MARTIN ÇUNI
LULET E JETËS

si përrallë, si anekdotë, apo edhe si përshkrim situatash e përjetimesh nga vetë autori.

Martin Çuni i ndërlidhë këto forma rrëfimesh i vetëdijshëm, nga se letrat e tilla kontrolloheshin, nga organet e burgut.

E ky për të dërguar mesazhe që nuk duhej hetuar nga censurës e hekurt e burgut mjeshtërisht

përdorte variante të tilla alegorike.

Në një letër shprehet kështu: "Si ju thashë më parë sorrat e kumritë janë në armiqësi të përbetuar. Ndosht shpeshherë të grinden mes tyre. Megjithëse janë të urta kumritë nuk dorëzohen".

Pa dyshim pra se me sorra

aludonte pushtuesit e kumri rezistencën shqiptare. Të tillë simbolikë me aludime gjejmë shpesh në letrat e këtij libri.

Poetike e referencës së këtij libri është mjaft e pasur, me figura të ndryshme letrare që më së shpeshti e luajnë rolin e metaforës si: zogu i lirë, pranvera e bukur, cicërimë e ëmbël, lejlek me fletë, psherëtimë e lumit, krahët e dritës e shumë kësisoj. Se e bukura qëndron në origjinalitet e jo në stisje, dëshmon edhe ky libër që lexuesit i shfaqet ashtu spontan si letër e shkruar në formë proze poezie, dorëshkrimi të ilustruar me peizazhe, fragmente nga qyteti e portrete të vizatuara nga vetë autori dhe shokët e tij të burgut.

Duke e lexuar me vëmendje këtë libër, si të gjithë librat e këtij autori, sidomos ato të të shkruara në burg dhe me temë burgu më kujtohet një sugjerim që i bëra këtij miku tim të veçantë se ky duhet shkojë shpeshherë në atë burg, por natyrisht jo fizikisht por me kujtime, se nga kujtimet e tilla mund të shkruhet letërsi e bukur. Bodleri thotë "Kujtimi është një palimpsest". Të rishkruarit mbi palimpsest është gjithmonë një letërsi e veçantë dhe e bukur siç është libri "Lulet e verës", për të cilin falënderoj mikun tim Martin Çuni që më ofroi kënaqësi si estetike gjatë leximit por dhe që më dha rastin të them dy-tre fjalë në këtë ambient të ngrohtë e solemn. Ju falënderoj shumë për vëmendjen!

Frankfurt, 13 tetor 2018

*Ky vështrim është lexuar me rastin e përrurimit të këtij libri në Ofembah të Gjermanisë.

Veseli: Vetëm me trajtim dinjitoz dhe meritator ngrehet niveli i krijimtarisë kulturore

PRISHTINË, 7 NËNTOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka prituri të mërkurën në takim punonjësit e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilët nga janari i vitit të ardhshëm do t'i marrin pagat me rritje prej 50 përqindësh. Me këtë rast Veseli ka thënë se vetëm me trajtim dinjitoz dhe meritator mund të arrihen rezultate në punë dhe në ngritjen e nivelit të krijimtarisë kulturore. "Pagat e punonjësve të institucioneve të

kulturës dhe të trashëgimisë kulturore nga ky muaj janë rritur për 50 përqind. Premtimi i dhënë është mbajtur. Vetëm me trajtim dinjitoz dhe meritator mund të arrihen rezultate në punë dhe në ngritjen e nivelit të krijimtarisë kulturore. Përgëzoj ministrin e Kulturës, Kujtim Gashi, për kujdesin ndaj artistëve, por edhe për përkushtimin për investime në infrastrukturën kulturore", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



E jashtëzakonshme

Restoranti më i madh nënujor në botë drejt përfundimit

Pesë metra poshtë sipërfaqes së Detit të Veriut, pranë jugut të Norvegjisë, restoranti i parë nënujor në Evropë është drejt përfundimit. Struktura rreth 34 metra e gjatë, një pllakë e pjerrët që duket si periskop i mbytur, u zhyt në det në korrik 2018-s, ndërsa tani po punohet



për ta përfunduar pjesën e brendshme. Hapja publike pritet të bëhet në pranverë të vitit 2019. Restoranti, i quajtur Under, është dizajnuar nga Snohetta.

FOTO E DITES



Njerëzit ecin nëpër një park me pemë shumëngjyrëshe dhe gjethe të rëna në Frankfurt. /AP/

E rrallë

Hyn në Google Earth, zbulon aeroplanin në fund të detit

Një burrë 'me sy shqiponje' ka zbuluar atë që duket si një avion i mbytur në Google Earth. Robert Morton gjeti imazhet e qarta të një aeroplanit në det jashtë Robert Morton. "Ishte e pabesueshme dhe e çuditshme. Isha duke kërkuar në Google Earth dhe më dolën pamjet e



aeroplanit", ka thënë 55-vjeçari nga Doncaster, South Yorks. Vendi në të cilin është dalluar aeroplanit është më pak se 9 milje nga Aeroporti i Edinburgut.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: I dashur, a të kujtohet se në këtë park ma ke vjedhur puthjen e parë?
Burri: Po si nuk më kujtohet, e dashur.
Gruaja: Për shkak të asaj hajnie po vuaj edhe sot.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.

Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.

Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.

Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.

Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse doni ta kaloni ditën në mënyrë konstruktive, duhet të filloni të programoni çdo gjë. Hiqni dorë nga impenjimet dhe gjithçka tjetër që ju pengon.</p>	 <p>DEMI Keni treguar që jeni mjaft sipërfaqësorë në përzgjedhjen e raporteve afektive kohët e fundit. Nëse nuk doni të lëndoheni, merrni masa.</p>	 <p>BINJAKËT Dilemat tuaja sot do t'ia lënë vendin sigurisë që do t'ju japë partneri dhe miqtë në hapat që keni pasur mjaft problem për të ndërmarrë.</p>	 <p>GAFORRJA Sot nuk mund t'i rezistoni një tavoline të shijshme që jeni ftuar. Edhe pse keni vendosur këtë kohë të kujdeseni për pamjen tuaj, sot do të devijoni nga dieta.</p>	 <p>LUANI Nëse doni të arrini diçka, sigurisht se ju i dini të gjitha mënyrat për t'ia arritur qëllimit. Ajo që keni zgjedhur të bëni nuk është shumë korrekte.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Po i jepni kohë vetes të filloni t'i shijoni momentet që ju ofron dita. Nga ngarkesa që keni pasur shumë gjëra kanë kaluar pa i vënë re.</p>
 <p>PESHORJA Duhet të impenjoheni shumë më tepër se zakonisht për ta arritur synimin tuaj sot. I keni vënë vetes një detyrë të vështirë që duhet ta realizoni.</p>	 <p>AKREPI Personat me të cilët po bashkëpunoni i keni kundërshtarë në çdo hap dhe ide tuajën. Gjithsesi, duhet të përpiqeni të jeni në një mendje në përfundim.</p>	 <p>SHIGJETARI Jeni të bindur që gjithçka sot varet nga humori dhe shpirti i iniciativës që do të keni. Do t'i gjeni personat e duhur që mendojnë si ju.</p>	 <p>BRICJAPI Nuk keni qenë shumë në dijeni të zhvillimeve të fundit me miqtë tuaj dhe sot do të bëni një gafë që një prej tyre nuk do ta pëlqejë.</p>	 <p>UJORI Sot nuk jeni shumë entuziast për sa po ndodh rreth jush. Në mbrëmje do të kërkonit të rrinë të qetë në ambient familjar.</p>	 <p>PESHQIT Nëse nuk keni provuar gjithçka, sot do të merrni një hap të rëndësishëm për t'i zhvilluar raportet tuaja personale dhe profesionale.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ARSENAL - SPORTING LISBON

1

CELTIC - RB LEIPZIG

2

DYNAMO KIEV - RENNES

1

Prishtina mposht Feronikelin, merr pozitën e parë

"Betejën" për pozitën e parë në IPKO Superligë e ka fituar skuadra e Prishtinës në përballje me Feronikelin, 0-1. Të vetmin gol për kryeqytetasit e realizoi Mario Morina, kurse vendësit nuk arritën ta shënojnë as golin e barazimit, ani pse luajtën rreth tridhjetë minuta me një lojtar më shumë

EPOKA E ENJTE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 NËNTOR - FC Prishtina ka shënuar një fitore të madhe në ndeshjen e mbetur të xhiros së dhjetë në elitën e futbollit të Kosovës, pasi e ka mposhtur Feronikelin me rezultat 0-1. Pas kësaj fitore skuadra kryeqytetase ka marrë kryesimin në elitë me 33 pikë të grumbulluara, kurse "Nikli" zbritet i dyti me 32 pikë. Atmosfera e krijuar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas ishte e jashtëzakonshme, për çfarë janë meritore tifozët "Tigrat e Zi" dhe "Plisat", kurse të pranishëm në stadium ishin rreth katër mijë shikues.

Trajneri Zekrija Ramadani pas ndeshjes është shprehur se skuadra e Feronikelit e ka merituar të paktën një pikë. "E merituar të paktën një pikë, por ky është futboll. E dinim se kush gabon një herë, do të realizojë gol dhe mund të fitojë. U munduam ta shmangim presionin para ndeshjes, por nuk ia arritëm. I përgëzoj lojtarët për angazhimin e bërë në këtë ndeshje dhe e uroj Prishtinën për këtë fitore, por kampionati është i gjatë", ka thënë Ramadani.

Pjesa e parë solli pak raste shënimi, ku për vendësit nuk u treguan të saktë Hoti e Da Silva, si dhe Kastriot Rexha në minutën e fundit, sikurse që nuk ishte i saktë as Kalhidi për mysafirët. Në pjesën e dytë rastet u shtuan për shënim, derisa Prishtina ishte ajo që kaloi në epërsi në minutën e 57, kurse Kalhidi e shërbeu për mrekulli Mario Morinën, i cili nuk e kishte të vështirë ta dërgojë topin në rrjetën e portierit Smakiqi. Në vazhdim vendësit i shtuan sulmet, kurse Prishtina në minutën e 64-t mbeti pa Diar Miftarajn, i cili u përjashtua me karton të kuq, pas dy kartonëve të verdhë. "Nikli" u mundua maksimalisht që ta shfrytëzoi epërsinë numerike për ta barazuar rezultatit, por mysafirët u mbrojtën mirë dhe arritën të dalin nga kjo ndeshje me maksimumin e



pikëve. Pas fitores së arritur në ndeshjen derbi, Mirel Josa është i kënaqur me vazhdimësinë e rezultateve pozitive që po tregon Prishtina. "Kjo fitore është e rëndësishme si të gjitha fitoret e tjera që kemi bërë. Jam i kënaqur me vazhdimësinë që skuadra e ka nga java në javë dhe nga mënyra se si lojtarët u janë përgjigjur fizikisht ndeshjeve të dendura që kemi pasur javët e fundit. Ishim të vendosur mirë në fushën e lojës, kemi nxjerrë përpara kundërshtarit me presion dhe arritëm të shënonim. Më pas u prishë ekuilibri me largimin e Miftarajt dhe, të them të drejtën, nuk jemi mbrojtur edhe aq mirë. Rëndësi ka vetëm fitorja dhe tani

duhet të mendojmë vetëm për ndeshjen e radhës", ka deklaruar Josa.

Ferizaj mposhti KEK-un

KEK-u vazhdon të jetë skuadra e fundit në tabelë me vetëm një pikë të grumbulluar në këtë edicion garash. Mbijetesa për këtë skuadër është një mision i pamundur, derisa të mërkurën e pësoi edhe humbjen e radhës nga Ferizaj me rezultat 1-2. Sulmuesi Dren Gashi shënoi një gol në pjesën e parë për rezultatit 0-1, kurse Ervin Kacar e dyfishoi epërsinë në 0-2, kurse krejt çfarë arriti skuadra vendëse në këtë takim ishte goli i shënuar nga Rilind Nimani.

SHKURT

Shaqiri mund të huazohet te Galatasaray

Mesfushori shqiptar Xherdan Shaqiri mund të huazohet te skuadra turke, Galatasaray. "Xherdan Shaqiri (27), i cili u transferua në verë te Liverpooli, është shënjestruar nga Galatasaray. Ish-lojtari i Bayern Muenchenit dhe Stoke Cityt mund të huazohet në janar", shkruan të mërkurën "transfermarketweb.com". Mesfushori i Zvicrës ka kontratë me Liverpoolin deri në vitin 2023.

Partizani e mposhti Kamzën, Laçi i fortë për Skënderbeun

Partizani rimerr vendin e parë në kampionatin shqiptar, pasi fitoi me rezultatit 1-2 kundër Kastriotit. Dy golat vendimtarë të ndeshjes u shënuan nga Jurgen Bardhi. Nga krahu tjetër, goli i vetëm për Kastriotin u shënuar nga Rogeri. Takimi ishte i një niveli mesatar dhe pati ritëm vetëm në pjesën e parë, në të dytën ra. Në ndeshjen tjetër Teuta e mposhti Kamzën me rezultat 3-1, kurse Laçi e mposhti Skënderbeun me rezultat 2-0.

Përfaqësuesja e femrave në Turqi për dy ndeshje miqësore

Përfaqësuesja A e Kosovës në konkurrencën e femrave të mërkurën ka udhëtuar drejt Antalyas në Turqi për përgatitje dhe zhvillimin e dy ndeshjeve miqësore. Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet agjentit të FIFA-s për ndërmjetësim të ndeshjeve, Kenan Kurtesh, ka aranzhuar edhe dy ndeshje me Kombëtaren A të Ukrainës. Ndeshjet do të zhvillohen më 9 dhe 12 nëntor. Për përzgjedhësen Afërditë Fazlija kjo përgatitje dhe këto dy ndeshje janë të mirëseardhura për të parë gjendjen dhe formën e futbollisteve, por edhe të skuadrës në përgjithësi. Të kujtojmë se herën e fundit Kosova në fillim të shtatorit pati dy ndeshje me Maqedoninë, ku në ndeshjen e parë luajti baras pa gola dhe në ndeshjen e dytë shënoi fitore me rezultat 2-0.

Sadiku dhe Ismajli i bashkohen Shqipërisë

TIRANË, 7 MARS - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci, e ka zbuluar listën e futbollisteve për ndeshjen ndaj Skocisë më 17 nëntor në "Loro Boriçi", takim i vlefshëm

për Ligën e Kombeve. Kuqezinjtë do të luajnë edhe me Uellsin në miqësoren e 20 nëntorit në "Elbasan Arena". Risi në listën e Panuccit është mbrojtësi Loret Sadiku, i cili ishte në të kaluarën

për Ligën e Kombeve. Kuqezinjtë do të luajnë edhe me Uellsin në miqësoren e 20 nëntorit në "Elbasan Arena". Risi në listën e Panuccit është mbrojtësi Loret Sadiku, i cili ishte në të kaluarën

Ardijan Ismajli, i cili ishte kapiten i Përfaqësueses së Kosovës U21. Lista e futbollisteve: T. Strakosha, E. Berisha, A. Hoxha, I. Balliu, E. Hysaj, E. Binaku, A. Ismajli, B. Xhimshiti, F. Veseli, E. Lenjani, K.

Dermaku, M. Mavraj, M. Basha, A. Lila, L. Memushaj, S. Lilaj, E. Gavazaj, L. Sadiku, E. Ndoj, Y. Ramadani, T. Xhaka, R. Manaj, M. Uzuni, E. Grezda, B. Balaj, G. Vrioni.

Haradinaj: Sportistët po ndjekin sukseset e Luan Krasniqit

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri në takim ish-bok-sierin Luan Krasniqi. Sipas

Haradinajt, sot më shumë se kurrë ka sportistë që ndjekin rrugën e Krasniqit. "Kënaqësi ta pres në takim kampionin tonë, Luan Krasniqin, sukcesi

ndërkombëtar i të cilit mbetet gjithmonë inspirim për brezat e ri. Sot, më shumë se kurrë, kemi sportistë që ndjekin rrugën dhe sukseset e Luanit.

Sportistët e formatit të tij ishin dhe janë imazhi më i mirë i Kosovës në botë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Milani i shkon Betisit, Arsenali e pret Sportingun

BETIS, 7 NËNTOR - AC Milan, pas humbjes që pësoi dy javë më parë në "San Siro" nga skuadra e Real Betisit (1-2), sonte (e enjte) i shkon kësaj skuadre në Spanjë me shpresën për t'i marrë pikët maksimale dhe mbetjen në garë për kualifikim në fazën tjetër. Në fakt, kuqezinjtë renditen të dytët në grup me 6 pikë, por një humbje nga Betisi dhe një fitore e Olympiacos ndaj Dudelanges mund t'i komplikojë shumë gjërat në këtë grup. Një skuadër tjetër e madhe në Evropa Ligë, Arsenali, pritet ta sigurojë sonte kualifikimin, pasi është favorit përballë Sportingut. Portugezët janë mposhtur edhe para dy



javësh nga ekipi i Granit Xhakës dhe Shkodran Mustafit. Chelsea është mysafire e Bate Borisovit,

derisa Lazio e Valon Berishës dhe Tomas Strakoshës do të luajë ndaj Marseillet.

GRUPI A 21:00 Bayer Leverkusen - Zuerich 21:00 Ludogorets R. - AEK Larnaca	GRUPI E 21:00 Arsenal - Sporting 21:00 Vorskla - Qarabag	GRUP I 18:55 Genk - Besiktas 18:55 Malmoe - Sarpsborg 08
GRUPI B 21:00 Celtic - Leipzig 21:00 Rosenborg - Salzburg	GRUPI F 21:00 Olympiacos - Dudelange 21:00 Real Betis - Milan	GRUPI J 18:55 Akhisarspor - Sevilla 18:55 Krasnodar - Standard Liege
GRUPI C 21:00 Bordeaux - Zenit 21:00 Slavia Prague - Koebenhavn	GRUPI G 18:55 Rapid W. - Villarreal 18:55 Spartak M. - Rangers	GRUPI K 16:50 Astana - Jablonec 18:55 Dynamo Kyiv - Rennes
GRUP D 16:50 Fenerbahce - Anderlecht 21:00 Dinamo Z. - Spartak Trnava	GRUPI H 18:55 Apollon Limassol - Eintracht F. 18:55 Lazio - Marseille	GRUPI L 18:55 BATE Borisov - Chelsea 18:55 Vidi - PAOK

Milwaukee ngecën ndaj Portlandit, fitojnë Dallasi e Brooklyn



PORTLAND, 7 NËNTOR - Katër ndeshje të luajtura në NBA, ku spikat humbja e Milwaukeees, skuadrës surprizë deri më tani, që u mund 118-103 nga Portlandi. McCollum me 40 pikë ishte shënuesi më i mirë për Portlandin, vendimtar në fushë për skuadrën e tij. Për Milwaukee u dalluan Middleton (22), Antetokounmpo (23) e

Lopez (22), por nuk mjaftoi për ta evituar humbjen e dytë sezonale. Fiton edhe Dallasi, që mundi 119-100 Washingtonin, ndeshje e dominuar nga vendësit, ku u dalluan Doncic me 23 pikë e Matthews me 22, ndërsa 24 pikë e 10 asiste të Wall për Wizardsit mbetën për statistikë. Ekipi i Brooklynit, falë 26 pikëve të

LaVert, mundi 104-82 Phoenixin, ndeshje e dominuar nga miqtë, ndërsa Charlotte mundi 113-102 Atlantan, sfidë ku diferencën në fushë e bëri Walker me 29 pikë.

REZULTATET		
Charlotte - Atlanta	113-102	
Dallas - Washington	119-100	
Phoenix - Brooklyn	82-104	
Portland - Milwaukee	118-103	

SHKURT

Wengeri mohon arrijten e marrëveshjes me Milanin

Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, i ka quajtur të rreme lajmet se ai do ta marrë drejtimin e Milanit. Në fillim të kësaj jave u spekuloi se francezi ishte buzë arrijtes së marrëveshjes me Milanin për ta zëvendësuar Gennaro Gattuson, por Wengeri e ka mohuar këtë në mënyrë kategorike. "E vetmja gjë që mund të them është se këto janë lajme të rreme. Nëse bëhem me klub të ri ju tregoj, por këto janë lajme të rreme. Nuk mund t'i kontrolloj thashethemet, por vetëm atë që e bëj në jetë. Jam i fokusuar për të bërë punë të mirë për BeIN Sports dhe nuk është e lehtë", ka thënë Wengeri për "BeIN Sports".

Spalletti: Kjo është vlera e Skriniarit

Mbrojtësi i Interit, Milan Skriniar, luajti një ndeshje fantastike ndaj Barcelonës. Në përfundim të takimit, gazetarët ngacmuan trajnerin zikaltër, Luciano Spalletti, duke e pyetur atë për vlerën që ai do t'i jepte kartonit të sllovakut. Tekniku toskan nuk iu shmang pyetjes dhe u përgjigj me një batutë: "100 milionë (euro). Po të isha Barça do të paguaja 120 milionë e do të thosha 20 milionëshi shtesë është bakshish, ndërsa po të isha Reali paguaja 100 milionë dhe do të lija 40 milionë bakshish".

Busquets: I padrejtë barazimi ndaj Interit

Mesfushori i Barcelonës, Sergio Busquets, është i zhgënjyer me barazimin e arritur në "San Siro" ndaj Interit (1-1), duke qenë se Barcelona dominoi në ndeshje. "E gjithë skuadra tregoi për të dytën ndeshje me radhë një sinjal të fortë. Bëmë një hap të madh përpara, duke ofruar sërish një futboll madhështor, edhe pa Messin në fushë dhe kjo është një tjetër 'armë' mbi të cilën duhet të punojmë. Sërish e dominuam ndeshjen dhe Interin në çdo aspekt. Ofruam një zotërim topi gati perfekt, por shpërdoruam shumë, sidomos në pjesën e parë dhe këtë e paguam me pësimin e një goli idiot. Nuk arrij ta kuptoj se si arriti topi që të karambolonte në zonë në atë mënyrë idiote, por e pësuam, ndaj herë tjetër duhet ta spastrojmë më shpejt zonën", ka thënë Busquets.

Ibra nuk kthehet te Milani

Zlatan Ibrahimoviç shuan në njëfarë mënyre shpresat e tifozëve të Milanit për ta parë me fanellën kuqezin në janar. Sulmuesi suedez në një prononcim të fundit theksoi se është optimist sa i përket rikthimit të Los Angeles Galaxy sezonin e ardhshëm. Skuadra kaliforniane dështoi të kualifikohej në fazën "play-off" të MLS në javën e fundit të sezonit të rregullt pasi u mposht 2-3 nga Dynamo Houston, duke nxitur raportimet se gjiganti suedez mund të kthehet në futbollin evropian, pikërisht në Milano me kuqezinjtë, ku ka kaluar një pjesë të karrierës së tij. Ibra, i cili realizoi 22 gola në 27 ndeshje me kalifornianët në këtë sezon, u shpreh se dëshiron ta respektojë deri në fund kontratën, që i skadon në fund të vitit 2019. "Unë dua të rikthehem, të jem i aftë për të rivalizuar për trofe. Nuk kam ardhur këtu për pushime, por për një sfidë. Dua ta ndiej që kam mundësi të jem më i miri në MLS. Sigurisht e kam fjalën për skuadrën, sepse unë jam më i miri. Dua që skuadra ime të rivalizoj ashtu siç duhet me të tjerët", ka thënë Ibrahimoviç. Drejtuesit e Los Angeles Galaxy dëshirojnë të bëjnë ndryshime të mëdha për sezonin e ardhshëm, ku në qendër të projektit mbetet Zlatan. Presidenti Chris Klein deklaroi: "Ajo që bëri Ibrahimoviç gjatë këtij viti është e dokumentuar, pati impakt të rëndësishëm në skuadrën tonë. Ai dëshiron të fitojë dhe ne duam të fitojmë me të".

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Haki Stërmilli"** - Zoqishtë,
Komuna: Rahovec
Data: **8.11.2018**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/094 - ESIP/SDG/094-G/1.1	Blerja e mjeteve të TIK-ut: kompjuter, laptop dhe mjete të tjera përcjellëse

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Haki Stërmilli"**- Zoqishtë, Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Kompjuter- PC - 7 copë
- Laptop - 2 copë
- Switch 16port- 1 copë
- Kabëll elektrike 6 porta- 3 copë
- Lan kabëll - 300 m
- Tavolina për kompjuter- 9 copë
- Karrige për kompjuter- 9 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkollës **"Haki Stërmilli"**- Zoqishtë, Rahovec, më së largu deri më **16.11.2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ilir Kryeziu Diart Morina
Telefoni: +38344280546 +37745884673
E-maili: ilir_kryeziu81@hotmail.com morinadiart120@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Shkolla/komuna: **"Hamëz Thaçi"** – Rahovec
Data: 08.11.2018
Emri i kontratës: Furnizim me kompjutera
Numri i kontratës: ESIP/SDG/095-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe shkollën **"Hamëz Thaçi"** (në Xërxë) – Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

1. Kompjuterë – 10 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën **"Hamëz Thaçi"**, në Xërxë, më së largu deri më 16.11.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës: Setki Kryeziu

Telefoni 044366254

E-mail: setkikryeziu@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Faik Konica"**- Celinë

Komuna: **Rahovec**

Data: **8 Nëntor 2018**

Emri i kontratës: Blerja e mjeteve të konkretizimit për shkencat e natyrës dhe arteve

Numri i kontratës: **ESIP/SDG/093 - ESIP/SDG/093-G/1.2**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe shkollën **"Faik Konica"**, Celinë-**Rahovec**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Pako per minikabinetin e Fizikës -1 copë
- Pako per minikabinetin e Biologjisë- 1 copë
- Paisje me mjete shkollore për arsimin fillorë 1-5
- Pako per minikabinetin e edukates muzikore dhe te artit figurativ
- Pako per minikabinetin e kimise 1 cope

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Adresa e Shkollës **"Faik Konica"**, Celinë-**Rahovec** më së largu deri më **16 Nëntor 2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ymer Fazliu, Manush Fazliu
Telefoni: 044 200 832, 044 642 591
E-maili: ymerfazliu@hotmail.com; manush.f@hotmail.com

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"SAPNIQI"**

Komuna: **Rahovec**

Data: **8.11.2018**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/099 - ESIP/SDG/099-CS/1.1	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Sapniqi"** Sapniqi - **Rahovec**.

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie**

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu" SAPNIQI" Sapniqi, Rahovec**, më së largu deri më 16.11.2018.

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Xhafer Gashi
Telefoni: 044/767127
E-maili: msusigjaf05@hotmail.com



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMVE NJRËZORË/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Komunikim dhe Marketing në Qendrën Kinematografike të Kosovës -QKK

Kategoria funksionale-Koeficienti : 7

Numri i referencës: 37/2018

I përgjigjet: Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës -QKK

Vendi: Prishtinë

Lloji i kontratës: "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj).

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën e komunikimit e në përputhje me ligjet, rregulloret, politikën dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyra në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Ben hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e komunikimit, kur kërkohet një gjë e tillë;
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij, për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohe pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thella në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word ,Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë e shkolles së mesme, minimum 1 vjet përvojë pune;
7. Gjuha angleze përparësi.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 15.11.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu br. 03/L-212, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Br. 03/L-149, i Uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Zvaničnik za Komuniciranje i Marketing u Centru Kinematografije Kosova (CKK)

Funkcionalna Kategorija: Koeficientat 7

Broj referencije: 37/2018

Odgovorani je: Direktor Centra Kinematografije Kosova

Mesto: Priština

Vrsta ugovora: "Sporazum o posebnim uslugama" (vremensko trajanje 6 meseci)

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora Centra Kinematografije Kosova izvršava dole navedene:

Zadatke i odgovornosti

1. Razvija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga i proizvoda;
2. Izvršava specializovane zadatke, prema zahtevu, iz specifične, profesionalne oblasti u podudarnosti sa dotičnim zakonima, pravilnicima, politikama i procedurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Izvršava zadatke iz specifične, iz oblasti komuniciranja, jednim razloznom stepenom samostalnosti, sa nadziranjem i uputstvima, s vremena na vreme;
4. Vršiti istraživanja i analize, prema zahtevu i doprinosi uređenju preporuka za razmatranje, sa najviših nivoa;
5. Učestvuju u radnim grupama iz oblasti za komuniciranje, kada se tako nešto zahteva;
6. Komunicira unutar institucije i van nje, za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti od zajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava svaki zadatak iz specifične, profesionalne oblasti, koji se razložno može zahtevati s vremena na vreme;

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko i specializovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treninga;
2. Poznavanje Zakona i Pravilnika koji se sprovode;
3. Sposobnost za komuniciranje planiranje rada i eventualno koordiniranje osobljem na administrativnom nivou;
4. Sposobnost za istraživanje, analitiku, procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
5. Kompjuterska sposobnost za aplikacije programa (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diploma srednje škole, minimum 1 godina radnog iskustva;
7. Prednost je engleski jezik.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na određeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 8 (osam) dana .

Zadnji datum za aplikovanje je: 15.11.2018

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Podnošenje Zahteva: Aplikacije se preuzimaju sa Ueb stranice MKOS-a, i predaju u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte na broj: 038211449 ili 038211921 (ili na web-stranici <http://www.mkrs-ks.org/>).



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

1. Titulli i pozitës së punës: Zyrtar Administrativ – AD/450

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)
Kategoria Funksionale: Niveli profesional 1
Gada e vendit të punës: 10
Koeficienti: 6
Lloji i pozitës: Karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Brenda fushës specifike, kryen detyra profesionale dhe administrative sipas kërkesës për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të njësisë organizative.

Detyrat kryesore:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe zyrtarin e lartë harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.
- Ndihmon në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës.
- Merr pjesë në hartimin, zhvillimin e procedurave dhe dokumenteve tjera si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në fushën profesionale specifike brenda afateve kohore të caktuara.
- Organizon dhe lehtëson takime, konferenca dhe ngjarje të tjera të veçanta, koordinon dhe merr pjesë në mbledhjet e komisioneve sipas rastit.
- Ofron ndihmë dhe mbështetje në zgjidhjen e problemeve, planifikimin dhe menaxhimin e projekteve, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara të njësisë organizative.
- Kryen hulumtime dhe analiza mbi çështjet, temave të caktuara nga mbikëqyrësi ose stafi i nivelit të lartë profesional dhe përgatit shkresa, raporte.
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave në fushat e interesit të përbashkët si dhe ofron përkrahje në fushën specifike profesionale për stafin e nivelit më të lartë profesional sipas kërkesës.
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkathësitë e kërkua:

- Njohuri profesionale në fushën e administratës.
- Shkathësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ.
- Shkathësi hulumtues, analitik, vlerësues të informacionit.
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Kushtet:

Diplomë universitare (Fakulteti për Administratë Publike dhe Filozofik, Juridik, Ekonomik) pa përvojë ose shkollë e lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune.

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË JO KARRIERËS

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

2. Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Biblioteka 1 – AR/550

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)
Kategoria Funksionale: Niveli Profesional 1
Gada e vendit të punës: 10
Koeficienti: 6
Lloji i pozitës: Jo Karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Zbaton strategjinë e gjithëmbarshme dhe planin gjithëpërfshirës në sektorin e Bibliotekës.

Detyrat kryesore:

- Në bashkëpunim me udhëheqësin harton dhe zhvillon planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.
- Dhënia e librave dhe materialeve tjera për shërbim në bibliotekë.
- Siguron përpilimin e regjistrit të librave të humbur për plotësimin e tyre me fotokopje.
- Përkujdeset për funksionimin e programit lidhur me librat, si dhe bënë përpunimin e librave në këtë program.
- Formimi i kartotekës dhe dhënia e informacioneve të përdoruesve.
- Përkrah zhvillimin e shërbimeve bibliotekare dhe të asiston në vlerësimin e këtyre shërbimeve.
- Siguron arkivimin dhe mirëmbajtjen e librave.

- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkathësitë e kërkua:

- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse që i ndihmon procesit të punës.
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
- Shkathësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Kushtet:

Diplomë universitare të fakultetit Filologjik, Edukimit, shoqëror, filozofik dhe administratë publike pa përvojë pune ose Shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune;

Dokumentacioni i kërkuar për pozitat e lartpërmendura:

- Fotokopja e vërtetuar e diplomës;
- Vërtetim mbi përvojën e punës;
- Dy - rekomandime;
